



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
DREJTORIA E PYJEVE PARQEVE DHE REKREACIONIT

PROJEKT VENDIM

NR _____ DATË. ____ . ____ .2026

PËR DISA NDRYSHIME TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK KOLONJË NR.44 DATË
07.07.2016, TARIFAT SHITESË NË SEKTORIN E KULLOTAVE

Në zbatim të Ligjit 9693 datë 19.03.2007 " Për Fondin Kulloror" të ndryshuar me disa ndryshime me Ligjin Nr.9996 datë 22.09.2008, si dhe për disa ndryshime dhe shtesa me Ligjin Nr. 49/2016, Udhezimi Nr. 2 datë 20.07.2016 " Për Kriteret Teknike të Klasifikimit të Kullotave dhe Livadheve dhe Procedurave të Dhënies së Tyre Për Kullotje e Kositje Bari" kreu II pika 2, Vendim Nr 467, date 31.7.2025 " Për Miratimin e Tarifave të Përdorimit të Kullotave dhe Livadheve për Kullotje ose Kositje, Ligji Nr. 57/2020 " Për Pyjet". Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve të administrimit të pyllit. Ligji Nr.139/2015 datë 17.12.2015 " Për Vetqeverisjen Vendore", Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e tij të dates
____ / ____ /2026

VENDOSI:

Pika 1 ndryshohet si vijon ,të miratohet tarifa e kullotës për Fermerët/familjet vendase sipas cilësimeve:

- Të imta tarifa 200 lek /Krerë.
- Të trasha tarifa 1000 lek /Krerë.
- Qëndër stani (vatha etj) tarifa 100 lek/m².

Pika 2 ndryshohet si vijon,të miratohet tarifa e kullotës për Fermeret/familjet jashtë Rrethit sipas cilësimeve:

- Të imta tarifa 300 lek /Krerë.
- Të trasha tarifa 1000 lek /Krerë.
- Qëndër stani (vatha etj) tarifa 100 lek/m².

Pika 3 ndryshohet si vijon të miratohet shtegëtimi i blektorisë nga Fermeret/familjet jashtë Rrethit që të kryhet me kamion apo mjete te tjera qe sigurojnë transportin e blektorise përmes rrugës Nacionale deri në destinacion (kullota e kontraktuar),afati ardhjes dhe largimit të jetë jo me shumë se 2 ditë.

Pika 4 nuk ndryshon ,Fermerë/familjet që kontarktojnë në pyje/kullota private duhet të paraqesin pranë Drejtoreisë së Pyjeve Parqeve dhe Rekreacionit këto dokumenta:

- Fotokopje kartës identitetit ID
- Numrin e krerëve
- Çertifikatën veterinare
- Vërtetim pronësie nga pronarët private (trashëgimtarët).

Konceptoi

Ing. Ervin ÇUKA

Pranoi

Petro KRISTO

NE MUNGESË DHE ME URDHER
NEN/KRYETAR

Petro RISTO

KRYETARI

Erion ISAI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
DREJTORIA E PYJEVE PARQEVE DHE REKREACIONIT

Nr 1312 prot.

Ersekë më 20.02. 2026

RELACION
PËR DISA NDRYSHIME TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK KOLONJË NR.44 DATË
07.07.2016, TARIFAT SHITESË NË SEKTORIN E KULLOTAVE

Nga ndryshimet e bëra në Ligjit 9693 datë 19.03.2007 " Për Fondin Kulloror" të ndryshuar me disa ndryshime me Ligjin Nr.9996 datë 22.09.2008, si dhe për disa ndryshime dhe shtesa me Ligjin Nr. 49/2016, Udhëzimi Nr. 2 datë 20.07.2016 "Për Kriteret Teknike të Klasifikimit të Kullotave dhe Livadheve dhe Procedurave të Dhënies së Tyre Për Kullotje e Kositje Bari" kreu II pika 2, Vendim Nr 467, datë 31.7.2025 " Për Miratimin e Tarifave të Përdorimit të Kullotave dhe Livadheve për Kullotje ose Kositje, pika 2 shtojca nr 1 dhe Ligji Nr. 57/2020 " Për Pyjet.

I propozojmë Këshillit Bashkiak të miratojë ndryshimet e bëra në Vendimin nr 44, datë 07.07.2016 të ardhura si pasojë e ndryshimeve të Legjislacionit dhe ndryshimin e tarifave për kullota verore me Vendimin nr 467, date 31.07.2025 si dhe ndryshimin e shtetimit per Fermeret jasht Rrethit qe te behet me mjete transporti dhe jo shtetimit me koridore pasi gjat ketyre viteve nuk kane respektuar intenerarin e percaktuar ne kete vendim,koha e shtetimit e kalonte 7 diteshin si dhe shkaktohej deme ne tokat bujqesore te familjeve fermere vendase.

Pas diskutimit nga anëtarët prezentë propozojmë të :

1. Te miratohet dhenia e dakordesise për ndryshimet e propozuara ne Vendimin nr 44, dt 07.07.2016.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Pyjeve , Parqeve dhe Rekreacionit dhe Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 për "Vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

Konceptoi
Specialisti I Kadastres dhe Kullotave

Ing. Ervin ÇUKA

Pranoi
Drejtori

Petro KRISTO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJE
KESHILLI BASHKIAK

Adresa Sheshi "RILINDJA" Erseke Kolonje

tel 081 22534 fax 081 2222

VENDIM

Nr.44 Date 07/07/2016

PER
MIRATIMIN E TRIFAVE SHITESH NE SEKTORIN E KULLOTAVE

Ne zbatim te ligjit nr date 19.03.2007 "Per Fondin Kullisor", Udhezimit te Ministrit nr.4 date 10.04.2008 "Per kriteret teknike te klasifikimit te kullotave e livadheve dhe procedurave per dhenien e tyre per kullotje e kositje,bari", Vendimit nr.6 date 19.02.2016 " Per miratimin e taksave dhe tarifave vendore" si dhe Ligjit 139/2015 date 17.12.2015 "Per Veteqeverisjen Vendore", neni 54 germa f, Keshilli Bashkiak Kolonje ne mbledhjen e tij date 07/07/2016

VENDOSI :

1. Te korigjohet dhe saktësohet ne Vendimin e Tarifave te fondit pyjor dhe kullisor Kap.II .12 pika 3 me kete cilesim: Kullotje per familjet vendase (poshte 50 krere te imta dhe 10 krere te trasha) .
 - Te imta 50 lek/krere
 - Te trasha 300 lek/krere
 - Qender Stani (vatha etj) 50 Lek/m²
- 2.Tarifa fermere qe shtegojne:
 - Fermere qe kontraktjne ne pyje/kullota te Bashkise 5000 lek/vit
 - Fermere qe kontraktjne ne pyje/kullota private 10000 lek/vit
- 3.Koridoret e shtegimit te jene 100-200 m gjeresi ne inteneraret e meposhteme:
 - a. Kufiri me Permetin parcela 13 Lulare-Lipeç-Radimisht-Ura e Kamnikut-Ish furra gelqeres Borove- Mbi Prodan – Zalli Rehove – Starje – Qafe Kazanit.
 - b.Qafa dellinjes Orgocke- Ura Osum-Lencke – Clirim- Qafzes-Ish Miniera Bezhan-DestinacionAfati i ardhjes dhe largimit nga territori i Bashkise Kolonje te jete jo me shume se 7 dite
4. Fermeret qe kontraktjne ne pyje/kullota private duhet te paraqesin prane sherbimit pyjor Bashkiak keto dokumenta:
 - Fotokopje te kartes se identitetit ID
 - Numrin e krereve
 - Certifikaten veterinare per shtegtim
 - Vertetim pronesis nga pronaret private (trashegimtare).

Lirjan HASENI

Kryetar i Keshillit te Bashkise



Nr. Prot. 4026
Dt. 04.8.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

Sekretar: Përgjithësisht
P. Zësto Ndihmëtar
Dr. Pyjeve, Përgjithësisht
Dr. Jundirke
Fajzëri 04.08.2025

V E N D I M

Nr. 467, datë 31.7.2025

P Ë R

MIRATIMIN E TARIFAVE TË PËRDORIMIT TË KULLOTAVE
DHE LIVADHEVE PËR KULLOTJE OSE KOSITJE,
PËR VEPRIMTARI SHOQËRORE, SHËNDETËSORE, SPORTIVE
E TURISTIKE DHE PËR PRODHIMIN E ENERGJISË
SË RINOVUESHME

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 15, dhe të pikës 5, të nenit 17, të ligjit nr.9693, datë 19.3.2007, "Për fondin kullosor", të ndryshuar, me propozim e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotjen e bagëtive ose për kositje të barit dhe për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike, si dhe për prodhimin e energjisë së rinovueshme, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.
2. Tarifat për dhënien në përdorim të kullotave e livadheve për kullotjen e bagëtive ose për kositjen e barit janë sipas shtojcës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Tarifat për dhënien në përdorim të kullotave dhe livadheve për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike janë sipas shtojcës nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Tarifat për dhënien në përdorim të kullotave dhe livadheve për prodhimin e energjisë së rinovueshme janë sipas shtojcës nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Pyjeve dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.
6. Vendimi nr.632, datë 11.6.2009, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje dhe kositje”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

BELINDA BALLUKU

**MINISTRI I TURIZMIT
DHE MJEDISIT**

MIRELA KUMBARO FURXHI

SHTOJCA NR.1

Tarifat për dhënie në përdorim të kullotave e livadheve për kullotjen e bagëtive ose për kositjen e barit

Kullotje	Lloji i bagëtive	Tipi i kullotës	
		Dimërore lekë/krerë/vit	Verore lekë/krerë/vit
1	Dhen	200	200
2	Dhi	250	250
3	Gjedh	1000	1000
4	Njëthundrakë	1200	1200
Kositje bari		Dimërore lekë/m ²	Verore lekë/m ²
			2
Ndërtime		Dimërore lekë/m ² /vit	Verore lekë m ² /vit
1	Qendër stani e rrethuar	100	100
2	Qendër përpunim bulmeti	150	150
3	Ngrehinë banimi për barinj të	50	50
4	Objekte ndihmëse për barinj të	150	150

SHTOJCA NR.2

Tarifat për dhënie në përdorim të kullotave dhe livadheve për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike

Aktiviteti	Tarifa lekë/ha/vit		
	Për 1 vit	2-5 vjet	6-10 vjet
Ndërtime agroturistike	100 000	80 000	65 000
Veprimtari sportive	140 000	100 000	85 000
Veprimtari çlodhëse dhe kampingje	100 000	85 000	65 000

SHTOJCA NR.3

Tarifat për dhënie në përdorim të kullotave dhe livadheve për prodhimin e energjisë së rinovueshme

Aktiviteti	Sipërfaqja (ha)	Kohëzgjatja (vjet)	Tarifat (lekë/vit)
Park fotovoltaiik	Deri në 10	Deri në 10	192 000
		Mbi 10	173 000
	Mbi 10	Deri në 10	156 000
		Mbi 10	132 000
Vendosje aerogjeneratorë	Deri në 10	Deri në 10	120 000
		Mbi 10	100 000
	Mbi 10	Deri në 10	90 000
		Mbi 10	70 000